



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI SPECIAL**  
**PS.nr.44/2023, datë 20.11.2024**

**FTESË PËR SEANCË**

**FTOHET** i akuzuari **DRAGAN DENIC**, i biri i Slobodan, lindur më datë 10.12.1967, në Leskovac, Republika e Serbisw, me vendbanim të panjohur jashtë Republikës së Kosovës, të marrë pjesë në seancën e shqyrtimit fillestar, të caktuar për datë **05.02.2025, e mërkurë, ora 09:00**, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, adresa: Rr. “Nekibe Kelmendi”, Pallati i Drejtësisë, Objekti D, Kati i I, D16, në çështjen penale sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, **PPS.nr.70/2020, datë 14.09.2023**, për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale: Krimet e luftës kundër popullsisë civile, nga neni 142, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (tutje: LPJ), aktualisht e inkriminuar si: Krime kundër njerëzimit, nga neni 143, par. 1, nënpar. 1.6 dhe 1.7, e lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.


Konform nenit 303, par. 8, të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje: KPP), Gjykata i bërë thirrje të të akuzuarit **Dragan Denic**, të dorëzohet dhe të paraqitet sa më parë pranë kësaj Gjykate, që kjo çështje penale të zhvillohet me prezencën e tij në seancën e caktuar me datë dhe në kohë si më lartë.

Konform nenit 303, par. 8, të KPP-së, Gjykata i bërë thirrje çdo personi që ka informacion relevant për vendndodhjen e të akuzuarit **Dragan Denic**, që t’ia komunikojë atë informacion policisë, me qëllim të sigurimi të prezencës së akuzuarit Ivica Rajkovic, në këtë çështje penale.

**Bashkangjitur:** Aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, **PPS. nr.70/2020, datë 14.09.2023**, kundër të akuzuarit **Dragan Denic**, për shkak të veprës penale si më lartë.



Kryetarja e trupit gjykues  
Rrahman Beqiri



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës / Kancelarija Specialnog Tuzilastva Republike  
Kosovo / Special Prosecution Office of the Republic of Kosovo

PPS nr. 70/2020  
Datë: 27.11.2023  
PRISHTINË

**GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË**  
- Departamenti Special -

Në bazë të nenit 234 par.2 dhe nenit 235 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), ushtroj këtë:

**A K T A K U Z Ë**  
për gjykim në mungesë

Kundër të pandehurve:

**Ivica Rajković (Rajković)**, i lindur [REDACTED] në Prishtinë, nga i ati Lubisha (Ljubiša), me adresë të fundit deri në vitin 1999, në rrugën [REDACTED] tani me vendbanim të panjohur, i nacionalitetit serb, ish pjesëtarë i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (MUP) në Stacionin policor në Vranjevc - Prishtinë.

**Dragan Denić (Denić)**, i lindur [REDACTED] në Leskovc, Republika e Serbisë, nga i ati Slobodan, me vendbanim të panjohur, i nacionalitetit serb, ish pjesëtarë i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë në Stacionin policor në Vranjevc- Prishtinë.

**S e p s e**

Si pjesëtarët e forcave policore të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, gjatë luftës në Kosovë, pas fillimit të bombardimeve të NATO-së me 24 mars 1999, në kundërshtim me rregullat e të drejtës ndërkombëtare humanitare, të përcaktuara në Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, gjatë një sulmi të gjerë dhe sistematik nga forcat ushtarake, policore dhe

paramilitare serbe, kundër popullatës civile shqiptare në territorin e komunës së Prishtinës, duke ditur për ekzistimin e një sulmi të tillë, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të këtij njësi, morën pjesë në dëbimin e popullatës civile shqiptare, plaçkitjen e tyre, kryerjen e dhunës fizike dhe psikike ndaj tyre, si dhe, me përdorimin e dhunës dhe veprimeve të tjera çnjerëzore, kanë kryer dhunim seksual ndaj gruas së nacionalitetit shqiptarë;

- me çka të pandehurit në bashkëkryerje me persona të tjerë të uniformuar dhe të armatosur ka kryer vepër penale Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22, të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht e inkriminuar si Krimet kundër njerëzimit nga neni 143 par.1 nënpar, 1.6; dhe 1.7; lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 237, par.3, nënpar 3.1, 3.2 dhe 3.3 të KPPRK-së, janë redaktuar të dhënat për të pandehurit.

Dispozitivi dhe arsyetimi i kësaj aktakuze janë redaktuar me qëllim të mbrojtjes së identitetit të viktimës, konform nenit 237, par.3, nënpar. 3.4 , dhe par.8 të KPPRK, si dhe në përputhje me Urdhrin e gjykatës për masë mbrojtëse PPPS.nr.33/2020, të datës 11.09.2020.

Redaktimi në këtë masë është i nevojshëm për arsye se nga përshkrimi i veprës penale në dispozitivin e aktakuzës, dhe nga përmbajtja e deklaratave të viktimës dhe dëshmitarëve, si dhe të dhënave të tjera në aktakuzë, mund të zbulohet identiteti i viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj, gjë që mund t'iu shkaktoj rrezik të rëndë dhe pasoja të pariparueshme.

**Drita Hajdari**

**Prokurore e Shtetit**

